



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 13, Datë 10.01.2018

**PËR
FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ALESIO-2014” SH.P.K NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA HEC “KRYEZI” ME FUQI TË INSTALUAR 1.99 MW.**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2 gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “a”; 5, pika 1 gërma “a”; 10 pika 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, dhe nenit 19 pika 1 të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 10.01.2018 mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “ALESIO-2014“ sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurave për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “ALESIO-2014” sh.p.k, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3; 4.1.4; 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me :

- Nenin 9, pika 3 gërma “d”, (vërtetimin e pagesës për aplikim në llogari të ERE-s), do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*”, ti paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi të ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e Shoqërisë “ALESIO-2014“ sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Kryezi” me fuqi të instaluar 1.99 MW.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI